



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Podujevë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Shkencave Shoqërore
Institucioni	Komuna Podujevë
Nr. i Referencës	RN00011926
Kodi	RPC0005519
Data e njoftimit	21.06.2023
Afati për aplikim	12.07.2023 - 26.07.2023

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- 1.Përfaqëson sektorin në nivel të DKRS-së dhe mban përgjegjësinë për mirëvajtjen e efektshme të punës në sektor;
- 2.Merr pjesë në planifikimin e zhvillimit të veprimtarive rinore në Drejtori;
- 3.Koordinon veprimet ndërmjet sektorëve dhe OJQ-ve rinore në Komunë;
- 4.Propozon strategjinë e punës, planin e veprimit si dhe masat që duhet të zbatohen në sferën e rinisë;
- 5.Inicion konsultimet lidhur me vendimet e marra në sektor dhe stimulon punën ekipore;
- 6.Promovon projekte dhe programe rinore në Komunë;
- 7.Merr pjesë në hartimin dhe publikimin e materialeve për promovime rinore;
- 8.Bashkëpunon me subjekte relevante nga fusha e rinisë;
- 9.Mbikëqyrë dhe raporton për realizimin e projekteve të mbështetura nga Drejtoria;
- 10.Organizon takime dhe bashkëpunon me OJQ dhe Qendra rinore në Komunë dhe jashtë saj;
- 11.Me kërkesë të mbikëqyrësit kryen punë dhe detyra shtesë në përputhje me natyrën e punës.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Drejtimi Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale;
- Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar
- Njohja e gjuhës angleze

5. Pozitat aktualisht të lira



Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0005015	RN00011388	Zyrtar për Rini	Profesional 2	GJ35-5/525.00 / 1	Komuna Podujevë	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Dokument që dëshmon që nuk jeni i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme të kërkuara për Grupin Specialistë të Shkencave Shoqërore.
- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin Specialistë të Shkencave Shoqërore.
- Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin Specialistë Ligjor që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

